



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Administratës



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 201500349/16

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2016

**Lënda:** *Rekomandohet marrja e nismës për fillimin e procedimit disiplinor ndaj punonjësit të Z.V.R.P.P. Durrës.*

**Drejtuar :** **Z.Arjan Bylykbashi**  
Kryeregjistruesit i Zyrës Qendrore të Rregjistrimit të  
Pasurive të Paluajtshme

**TIRANË**

Z.Bylykbashi!

Institucioni i Avokatit në procesin e shqyrtimit të ankesës së shtetasit Bilbil Peza, me banim në Lagjen nr.1, Rruga "Taulantia", Pallati 114, Durrës, në të cilën prezantohet shqetësimi i mosdhënies së dokumenteve të pronësisë për pasurinë e regjistruar në rregjistrin hipotekor me numër 456, datë 06.10.1994, në pronësi të tij, dhe për të cilën ankuesi ka kërkuar, (aplikimi nr.1818, datë 10.02.2016) lëshimin e tyre, Institucioni i Avokatit të Popullit në procesin e shqyrtimit të rastit të prezantuar, në mënyrë të përsëritur ka kërkuar ZVRPP, Durrës, me shkresat nr.K3/B7-2 Prot, datë 27.04.2015, nr.K3/B7-6 Prot, datë 05.01.2016 dhe nr.K3/B7-9 Prot, datë 07.03.2016, informacion dhe shpjegime rreth kësaj çështjeje.

Pa shkak të bërë të ditur, ZVRPP, Durrës, nuk ka përmbushur dhe nuk përmbush në afat detyrimin ligjor për dhënien e informacionit të kërkuar, konform sanksionimit të kryer në nenin 63/4 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, nenin 19 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar, si dhe nenin 70 të ligjit nr.33/2012, "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", i ndryshuar.

Edhe pse ju z.Kryeregjistrues, keni kërkuar dhe tërhequr vëmendjen Regjistruesit të ZVRPP, Durrës, me shkresat nr.4136/3 Prot, datë 25.07.2015, nr.335/2 Prot, datë 26.02.2016, dhe nr.335/6 Prot, datë 10.09.2016 (autori-gabimisht, duhet 10.08.2016) për përmbushjen e rregullt të detyrës, konstatohet se, drejtuesi i këtij organi nuk ka reaguar dhe nuk reagon në ushtrimin e funksioneve në mënyrë të rregullt e të ligjshme.

Gjithashtu në procesin e shqyrtimit të këtij rasti, Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Inspektimit të Institucioneve të Varësisë dhe Profesioneve të Lira, me shkresat nr.B-16/1 Prot, datë 03.02.2016 dhe nr.B-104/1 Prot, datë 26.05.2016, ka kërkuar organit që

ju përfaqësoni si dhe ZVRPP, Durrës, përmbushjen e detyrimeve ligjore në marrëdhënie me Institucionin e Avokatit të Popullit.

Përkundër kësaj situatë, si më sipër prezantuar, qëndrimi i punonjësve të ZVRPP, Durrës, është tregues i shkeljes së parimit të ligjshmërisë, transparencës, informimit, dhënies së ndihmës aktive, drejtësisë dhe paanësisë, përgjegjësisë, deburokratizimit dhe efikasitetit, sikurse parashikuar në nenet 4, 5, 6, 10, 13, 14, 15, dhe 18, të ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të detyrueshme për zbatim në kuptim dhe zbatim të parashikimeve të nenit 1 të këtij Kodi.

Kjo situatë e krijuar prej punonjësve të ZVRPP, Durrës, gjithashtu nuk vjen në përputhje me parimin për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, sikurse sanksionuar në nenin 42/2 të Kushtetutës apo nenin 6/1 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ratifikuar me ligjin nr.8137, datë 31.07.1996 “Pë ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”.

Përpos situatës së prezantuar, konstatohet se, Regjistruesi i ZVRPP, Durrës, nuk ka përmbushur dhe nuk përmbush detyrimin ligjor në marrëdhënie me Institucionin e Avokatit të Popullit, duke u bërë në këtë mënyrë penges për Institucionin e Avokatit të Popullit, në ushtrimin e detyrës për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, në mënyrë sa më efikente dhe në një afat sa më të arsyeshëm

Për arsyet e bëra të ditura, në përputhje me nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në të cilin sanksionohet se; “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga Administrata Publike”, si dhe nenit 22 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar,

## **REKOMANDOJMË**

*Marrjen e nismës për fillimin e procedimit disiplinor ndaj punonjësit të Z.V.R.P.P. Durrës, i cili nuk ka përmbushur dhe nuk përmbush detyrimin ligjor në marrëdhënie me Institucionin e Avokatit të Popullit.*

Në përfundim të shqyrtimit të rekomandimit, konform parashikimit të kryer në nenit 22 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, kthimi i përgjigjes duhet të kryhet brenda 30 ditëve nga data e dërgimit të kësaj shkresë.

*Bashkëlidhur ju dërgojmë,*

*Kopje të shkresës nr. K3/B7-2 Prot, datë 27.04.2015, të Avokatit të Popullit, drejtuar Regjistruerit të ZVRPP, Durrës*

*Kopje të shkresës Nr.4136/3 Prot, datë 25.07.2015, të ZQRPP, Tiranë, drejtuar ZVRPP, Durrës.*

*Kopje të shkresës nr. K3/B7-6 Prot, datë 05.01.2016, të Avokatit të Popullit, drejtuar ZQRPP, Tiranë.*

*Kopje të Shkresës nr.B-16/1 Prot, datë 03.02.2016, të Ministrisë së Drejtësisë, drejtuar ZQRPP, Tiranë.*

*Kopje të shkresës nr.335/2 Prot, datë 26.02.2016, të ZQRPP, Tiranë, drejtuar ZVRPP, Durrës.*

*Kopje të shkresës nr. K3/B7-9 Prot, datë 07.03.2016, të Avokatit të Popullit, drejtuar ZQRPP, Tiranë.*

*Kopje të shkresës Nr.B-104/1 Prot, datë 26.05.2016, të Ministrisë së Drejtësisë, drejtuar ZQRPP, Tiranë, dhe ZVRPP, Durrës.*

*Kopje të shkresës nr.335/6 Prot, datë 10.09.2016,(duhet-10.08.2016) të ZQRPP, Tiranë, drejtuar ZVRPP, Durrës.*

**KOMISIONERI**

**Arben SHKEMBI**

**Konceptoi dhe Daktiligrafoi  
A.Gjoleka**